

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK
DREJTIMI NDËRKOMBËTARË**



Tema e Masterit

Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe përgjegjësia për të mbrojtur

**Mentori:
Prof. Dr. Enver Hasani**

**Kandidati:
Vlora Pacolli Rexhepi**

Prishtinë, Dhjetor 2024

ABSTRAKT

Me datë 26 qershor 1945 në San Francisko u nënshkrua Karta e Kombeve të bashkuara e cila hyri në fuqi më 24 tetor 1945, duke krijuar kështu një organizatë ndërkombëtare nën emërtimin "Kombet e Bashkuara".

Edhe pse, me themelimin e saj, Kombet e Bashkuara kishin marrin përsipër të ruajnë paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare, kjo organizatë kishte dështuar të përgjigjej në tragjeditë si në: Ruandë, Bosnje dhe Hercegovinë, Somali dhe në Kosovë.

Gjenocidet në Ruandë, Bosnje, Somali dhe në Kosovë, megjithatë, ngritën nevojën për veprim nga bashkësia ndërkombëtare, për të mbrojtur jo vetëm shtetet, por edhe njerëzit. Dështimin e komunitetit ndërkombëtar për t'ju përgjigjur këtyre gjenocideve e kishte kuptuar edhe Kofi Anan, i cili ishte Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm në Departamentin e OKB-së për Operacionet Paqeruajtëse gjatë gjenocidit të Ruandës. Për këtë Annan kishte kërkuar edhe ri përcaktimin e nocioneve tradicionale të Sovranitetit. Në vitin 2000 dhe në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Annan shkroi raportin "Ne Popujt" mbi rolin e Kombeve të Bashkuara në shekullin 21 dhe në këtë raport ai shtroi pyetjen e mëposhtme: "Nëse intervenimi humanitar është, në të vërtetë, një sulm i papranueshëm mbi sovranitetin, si duhet t'i përgjigjemi një Ruande, një Srebrenica - për shkelje të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut që fyejnë çdo parim të njerëzimit tonë të përbashkët".

Prandaj iniciues kryesor i përgjegjësisë për të mbrojtur njihet Kofi Anan, iniciativë e cila një vit më vonë u mbështet nga Komisioni Ndërkombëtar për ndërhyrjen dhe sovranitetin shtetëror ku në raportin e tij u prezantua përgjegjësia për të mbrojtur, koncept i cili mendohej të kapërcejë hendekun mes parimit të mosndërhyrjes dhe nevojës për mbrojtjen e të drejtave, i cili që përpunuar tërësisht, duke paraqitur parimet, metodat dhe masat parandaluese, e që në vitin 2005 në dokumentin e samitit ndërkombëtar kishte gjetur miratimin nga shtetet anëtare por në një version më ndryshe nga ai në raport.